



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 321/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e subjektit politik FJALA dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 14.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e pasafatshme ankesa Anr.321/2017 të datës 13.06.2017, parashtruar nga subjektit politik FJALA dega në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 11.06.2017.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13 qershor 2017, nga subjekti politik partia Fjala dega në Prishtinë me të cilën pretendon se shkeljet e bëra lidhur me procesin e votimit janë bërë në KQZ, pasi që i njëjti institucion e ka dërguar në KKZ një tabelë duke i deturuar të shpërndahen komisionarët sipas formulës 3-3-2. Më tutje thekson se partisë Fjala nuk i është lejuar ti dorëzoj listat e komisionerve në KKZ, pasi që koalicionet edhe pse veprojnë si një listë zgjedhore, ndërkaq përfaqësimi i tyre ka qenë me nga 3 komisioner në të dy koalicionet dhe 2 komisioner nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV. Parashtruesi i ankesës thekson se, bazuar në rezultatet zyrtare të KQZ-së, nga numëri i madhë i fletvotimeve të pavlefshme, konsiderojmë se është manipuluar me votat si pasoj e mungesës së komisionerëve . PZAP-it i ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave dhe rishikimi i atyre që janë shpallur të pavlefshme .

Paneli pas shqyrtimit paraprak të afatshmerinë së ankesës gjeti se:

### **Ankesa është e pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5.3 Rregullorës Nr. 02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 13.06.2017.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjorë për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka

qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesën e ka parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 Rregullorës Nr. 02/2015 119, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr.321/2017 më datën 14.06.2017



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.